



VERTIGO FREE ZONE
DURRES INDUSTRIAL PARK

KU BIZNESI TAKOHET ME MUNDËSINË

*Zona e lirë ekonomike
më e re në zemër të
Shqipërisë!*



Tabela e Përmbajtjes

01.	Hyrja & Vizioni.....	4
02.	Vendndodhja Strategjike.....	8
03.	Përmbledhje e Masterplanit dhe Zonave.....	12
04.	Sektorët Idealë të Biznesit.....	16
05.	Zhvilluar për Biznes: Infrastrukturë & Lehtësi Operacionale.....	20
06.	Lehtësirat Fiskale & Incentiva Investimi.....	26
07.	Filloni Lehtësisht.....	30
08.	Shërbime të tjera suplementare.....	32

Hyrja & Vizioni

01

01 Hyrja & Vizioni

1.1 Disa fjalë nga Ekipi i Vertigo

Mirësevini në Vertigo Free Zone – Standardi i Ri për Zhvillimin Industrial

I vendosur strategjikisht në zemër të korridorit tregtar të Shqipërisë, Vertigo Free Zone nuk është thjesht një projekt zhvillimi, është një bazë strategjike për kompanitë që janë gati të zgjerojnë aktivitetin e tyre. Projektuar duke pasur në mendje efikasitetin, fleksibilitetin dhe zgjerimin ndërkombëtar, parku ynë industrial sjell së bashku infrastrukturë të personalizuar, procedura të thjeshtuara dhe lehtësira ekonomike për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për bizneset me vizion për të ardhmen.

Qoftë një prodhues, operator logjistik, inovator teknologjie apo tregtar global, Vertigo Free Zone ofron një bazë të zgjuar për rritje afatgjatë. Me Portin e Durrësit vetëm pak minuta larg dhe akses të shpejtë në tregjet kryesore europiane, biznesi juaj rritet me shpejtësi, me efikasitet dhe siguri.

— Ekipi i Vertigo



1.2 Pse Vertigo Free Zone?

Çfarë Ofron Vertigo Free Zone

Park industrial me shërbime të integruara dhe infrastrukturë të personalizuar



Procedura të thjeshtuara dhe rregulla të favorshme për investitorët



Hapësira të gatshme për kompani inovative dhe digjitale



Vendndodhje strategjike, vetëm 6.77 km nga Porti i Durrësit dhe rrjetet kryesore rrugore



Njësi të personalizueshme për prodhim, magazinim, zyra dhe hapësira tregtare



Lehtësira fiskale dhe doganore për uljen e kostove operacionale



Misioni ynë

Të bëhemi destinacioni më konkurrues dhe efikas për biznesin në Shqipëri, ku kompanitë zgjerohen pa pengesa, zhvillohen dhe operojnë me mbështetje të plotë.



Vizioni ynë

Të kthejmë Vertigo Free Zone në një qendër rajonale për prodhim industrial, logjistikë dhe inovacion, e lidhur në mënyrë të përsosur me tregjet europiane dhe globale.



Vendndodhje Strategjike


02

*“Në Kryqëzimin e
Tregtisë dhe Mundësive”*

2.1 Avantazhi Rajonal

Vertigo Free Zone ndodhet pranë qytetit të dytë më të zhvilluar në **Shqipëri, Durrësit**, vetëm **18.24 km** nga **Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”**, **25.54 km** nga kryeqyteti i Shqipërisë, **Tirana**, dhe **6.77 km** nga porti më i madh në Ballkan, **Porti i Durrësit**.


I pozicionuar përgjatë **autostradës Tiranë-Durrës** dhe si pjesë e **Korridorit VIII**, Vertigo Free Zone ofron akses rrugor të drejtpërdrejtë drejt **Maqedonisë së Veriut, Kosovës, Greqisë** dhe tregut të BE-së përmes Italisë dhe më gjerë.



2.2 Akses në Forma të Ndryshme

Ajror:

Vetëm 30 minuta larg nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA), për udhëtime biznesi, logjistikë dhe transport ajror mallrash.



Detar:

Akses i drejtpërdrejtë në Portin e Durrësit, me lidhje të rregullta në rrugët detare të Adriatikut dhe Mesdheut.

Rrugor:

Akses i menjëhershëm në autostradën A2, që lidh Tiranën, Durrësin dhe qendrat kryesore logjistike në Shqipëri dhe Ballkan.

2.3 Porta Juaj drejt Europës

Nëpërmjet Vertigo Free Zone, bizneset fitojnë akses të shpejtë dhe efikas në mbi 500 milion konsumatorë të Bashkimit Europian, me korridore tregtare të optimizuara për:

- Aktivitetet e importit/eksportit
- Logjistikën e tregtisë elektronike
- Shpërndarjen rajonale dhe ndërkombëtare të mallrave





Përmbledhje e Masterplanit dhe Zonave

03

03 Përmbledhje e Masterplanit dhe Zonave

3.1 Pamje e Përgjithshme e Masterplanit

Vertigo Free Zone shtrihet në një sipërfaqe të strukturuar në mënyrë të organizuar, të optimizuar për produktivitet industrial, qarkullim efikas dhe fleksibilitet operacional afatgjatë. Çdo zonë është planifikuar me kujdes për të përmbushur nevojat specifike të bizneseve moderne, qoftë për ndërtimin e një qendre logjistike rajonale, njësie prodhimi apo operacioni tregtar fleksibël.



3.2 Kategoritë e Zonave

Industria & Prodhimi

E projektuar për prodhim të lehtë deri në të mesëm, kjo zonë ofron njësi të ndërtuara sipas kërkesës, procese me performancë të lartë dhe linja prodhimi modulare.



Logjistikë & Magazininim

E vendosur pranë daljeve kryesore të transportit, kjo zonë është ndërtuar për logjistikë me qarkullim të shpejtë, duke ofruar magazina moderne, njësi për përpunimin e mallrave dhe akses të drejtpërdrejtë në autostradë.



Zyra & Administratë

Një qendër për menaxhim, administratën dhe shërbimet e biznesit. Përfshin ndërtesa zyrash të pavarura ose të përbashkëta, të lidhura plotësisht me infrastrukturë digjitale.



Tregti & Showroom

Zona ideale për demonstrime produktesh, shitje B2B dhe tregti me pakicë të lidhur me produkte industriale, të pozicionuara për vizibilitet dhe akses maksimal.



Inovacion & Teknologji

E përshtatur për R&D, teknologji të gjelbra dhe startup-e të automatizimit. Këto qendra mbështesin infrastrukturë digjitale, teknologjinë dhe zgjidhjet për të ardhmen.



3.3 Karakteristikat Kryesore të Planit të Përgjithshëm

- Rrjet rrugor i brendshëm me akse të gjera për qarkullimin e kamionëve
- Rrugë të dedikuara për qarkullimin e mjeteve të rënda të transportit
- Infrastrukturë nëntokësore e integruar dhe shërbime të centralizuara
- Fleksibilitet në ndarjen e parcelave sipas madhësisë dhe funksionit të kompanisë
- Ndarje e qartë ndërmjet zonave industriale, tregtare dhe inovative



Sektorët Idealë të Biznesit

04

*“E Përshtatur për Biznese
që Rriten Shpejt, Zhvillohen
me Zgjuarsi dhe Mendojnë
Globalisht.”*

04 Sektorët Idealë të Biznesit

4.1 Avantazhi Rajonal

Vertigo Free Zone është ndërtuar për kompani që kërkojnë efikasitet, fleksibilitet dhe avantazh strategjik afatgjatë në Europën Juglindore. Nga njësitë industriale të personalizueshme deri te qendrat logjistike me incentiva tatimore, Vertigo Free Zone mbështet të gjithë gamën e biznesve, nga ato fillestare deri te selitë rajonale.



4.2 Kategoritë e Zonave



Prodhimi Industrial & i Specializuar

- Industria e rëndë
- Industria e mobilerisë
- Industria automobilistike dhe pjesëve të këmbimit
- Pajisje mjekësore dhe produkte farmaceutike



Teknologji & Infrastrukturë Digjitale

- Qendra të të dhënave dhe infrastrukturë “cloud”
- Kompani të fushës së IT-së
- Zhvillim software dhe zyra mbështetëse
- Qendra kërkimi dhe zhvillimi (R&D)
- Shërbim dhe montim të pajisjeve të teknologjisë së lartë



Prodhimi i Lehtë & Montimi

- Tekstile dhe veshje
- Ambalazhe dhe materiale plastike
- Elektronikë dhe makineri të vogla
- Produkte shtëpiake
- Printim dhe etiketim



Ndërmarrje Tregtare & Shitje me Pakicë

- Ambiente ekspozimi për produkte (showroom)
- Furnitorë industrialë B2B
- Logjistikë tregtare e bazuar në shitje me pakicë
- Operatorë shërbimesh (financë, mbështetje biznesi)



Agro-përpunim & Industria Ushqimore

- Ushqime të përpunuara dhe pije
- Produkte të ngrira ose të ambalazuara
- Magazinin në sasi të mëdha për produkte bujqësore të papërpunuara
- Paketim dhe etiketim për eksport



Logjistikë & Transport

- Kompani transporti dhe kompani logjistike të palëve të treta
- Magazinin frigoriferik dhe logjistikë ushqimore
- Qendra shpërndarjeje (përfshirë tregtinë elektronike)
- Operatorë importi/eksporti
- Qendra rajonale të shpërndarjes

4.3 Pse Këta Sektorë?

Këta sektorë përfitojnë nga avantazhet që ofron Vertigo Free Zone, përfshirë:

- Akses të shpejtë në port për import dhe eksport
- Njësi të personalizueshme që përshtaten me nevojat e biznesit
- Lehtësira fiskale dhe reduktim të burokracisë
- Qasje qendrore në korridorin ekonomik më të madh të Shqipërisë
- Fuqi punëtore rajonale e kualifikuar në sektorët teknikë dhe të shërbimit



Zhvilluar për Biznes: Infrastrukturë & Lehtësi Operacionale

05

05 Zhvilluar për Biznes: Infrastrukturë & Lehtësi Operacionale

5.1 Infrastrukturë me Standard Industrial

Vertigo Free Zone është ndërtuar për të ofruar performancë të lartë industriale. Çdo komponent, nga rrjetet rrugore deri te shërbimet nëntokësore, është projektuar për të thjeshtuar proceset operacionale dhe për të reduktuar kohën e vendosjes së biznesit në zonë.

Elementët Kyç të Infrastrukturës:

Rrjet rrugor i brendshëm për qarkullim të dyanshëm të kamionëve




Rrjet energjie i dedikuar me kapacitet të personalizueshëm për çdo njësi

Plane të gatshme për sinjalistikë dhe rrethim sigurie



Parcela të personalizueshme me dimensione fleksibël





5.2 Infrastruktura Digjitale

Vertigo Free Zone ofron akses të menjëhershëm dhe të plotë në të gjitha shërbimet bazë dhe infrastrukturën digjitale, që nga dita e parë e operimit.

Infrastrukturë Digjitale:

- Internet me fibër optike në të gjithë zonën
- Njësi zyrash të gatshme për përdorim me mbështetje IT sipas nevojës
- Zona teknologjike të përshtatshme për infrastrukturë cloud dhe lidhje të avancuara



5.3 Aksesit dhe Qarkullimi

Struktura e brendshme e Vertigo Free Zone ofron qarkullim optimal të mallrave dhe njerëzve:

- Qarkullim për logjistikë të optimizuar
- Hyrje të dedikuara për kamionë, punonjës dhe vizitorë
- Hapësira parkimi për kamionë, automjete shpërndarjeje dhe stafin



5.4 Mbështetje për Biznesin

Fillimi i operacioneve në Vertigo Free Zone është i shpejtë, i qartë dhe miqësor për investitorët.

Zona ofron:





5.5 Infrastrukturë që favorizon teknologjinë

Mbështetje për Inovacionin

Edhe pse Vertigo Free Zone është projektuar kryesisht për industri prodhimi, logjistikë dhe aktivitete tregtare, zona ofron gjithashtu një mjedis të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt së ardhmes për bizneset që bazohen në teknologji dhe synojnë efikasitet operacional.

Falë infrastrukturës së avancuar digjitale, zonave fleksibël dhe rregulloret miqësore për investitorët, kompani nga sektorë si logjistika e tregtisë elektronike, shërbimet IT apo prodhimi i avancuar mund të operojnë në mënyrë të qetë dhe efektive, pa pasur nevojë për një ekosistem të dedikuar teknologjik.



Vertigo Free Zone ofron:

**Internet me fibër optike
dhe infrastrukturë të
gatshme** në të gjitha zonat



**Hapësira të
personalizuara zyrash
dhe prodhimi** për
procese operacionale
digjitale



**Procedura të
përsheptuara për leje
dhe licencim** për dalje
më të shpejtë në treg



**Akses në një fuqi
punëtore rajonale të
kualifikuar**, përfshirë
profile mbështetëse dhe
teknologjike



Me infrastrukturë të gatshme dhe pa burokraci, Vertigo Free Zone i ndihmon idetë tuaja të kalojnë nga koncepti në zbatim, pa pengesat tipike operacionale.



Lehtësirat Fiskale & Incentiva Investimi

06


*“Projektuar për të
Shpërblyer Rritjen Tuaj.”*

00 Lehtësirat Fiskale & Incentiva Investimi

Një nga avantazhet më të mëdha të Vertigo Free Zone është sistemi i tij fiskal i orientuar drejt investitorëve. Qoftë një ndërmarrje e huaj apo kompani vendase që synon zgjerimin, Vertigo Free Zone ofron një paketë të plotë përfitimesh tatimore, ulje kostosh dhe procedura të thjeshtuara, të dizajnuara për të minimizuar ngarkesën operationale dhe për të përshpejtuar rritjen afatgjatë.


6.1 Tatimi mbi Fitimin & Incentiva për Investimet Kapitale

Vertigo Free Zone e bën ri-investimin tërheqës duke ulur detyrimet tatimore gjatë viteve të para të aktivitetit:



6.2 Lehtësira mbi TVSH-në & Doganat

Për të mbështetur tregtinë aktive dhe logjistikën, Vertigo Free Zone zbaton një praktikë të favorshme të TVSH-së dhe doganave:



6.3 Përrjashtime nga Tatimi mbi Pronën & Asetet

Vertigo Free Zone redukton ndjeshëm kostot fikse përmes përfitimeve të rëndësishme në lidhje me tatimin mbi pronën:


Pa tatim mbi ndërtesat brenda zonës për një periudhë 5-vjeçare




0% tatim mbi transferimin e pronës për përdoruesit që zotërojnë pasuri të paluajtshme brenda zonës

6.4 Incentiva për Punësimin & Inovacionin


Për të nxitur zhvillimin e talenteve dhe inovacionin, Vertigo Free Zone shpërblen kompanitë që investojnë në njerëz dhe ide:



150%
zbritje tatimore për pagat dhe kontributet e punëdhënësit



200%
zbritje tatimore për shpenzimet e trajnimit të punonjësve, për një periudhë 10-vjeçare



200%
zbritje tatimore për shpenzimet në fushën e kërkimit dhe zhvillimit (R&D), për një periudhë 10-vjeçare





6.5 Procedura të Thjeshtëzuara Doganore & Lehtësira Tregtare

Për kompanitë që operojnë në tregti ndërkufitare apo në zinxhirë furnizimi, Vertigo Free Zone ofron:

- Zyra doganore brenda zonës dhe agjentë të autorizuar
- Procedura të përshpejtuara për zhdoganim
- Mundësi për të operuar në magazina doganore brenda zonës



6.6 Mbështetje për Fillimin e Investimit

Përtej përfitimeve financiare, Vertigo Free Zone ofron mbështetje praktike për të siguruar një hyrje pa pengesa në zonë:

- Udhëzime për regjistrimin e kompanisë dhe licensimin
- Asistencë për dokumentacionin tatimor dhe procedurat fiskale
- Koordinim i drejtpërdrejtë me ekspertë ligjorë dhe kontabël përmes rrjetit tonë të partnerëve
- Dokumentacion dhe asistencë në tre gjuhë: anglisht, shqip dhe italisht



Filloni Lehtësisht 07

*“Nga Kontakti i Parë deri te
Funksionaliteti i Plotë.”*

07 Filloni Lehtësisht

Në Vertigo Free Zone, ne besojmë se ngritja e një biznesi nuk duhet të jetë proces i ngadaltë apo i ndërlikuar. Prandaj kemi krijuar një proces integruar të thjeshtëzuar, me mbështetje të vazhdueshme në çdo hap, nga ndarja e tokës deri te licencat dhe logjistika



Shërbime të tjera suplementare

08

*“Projektuar për Njerëzit.
Gati për Funkcionalitet
të Përditshëm.”*

08 Shërbime të tjera suplementare

Edhe pse Vertigo Free Zone është optimizuar për efikasitet industrial dhe tregtar, ofron gjithashtu shërbime dhe lehtësira që e bëjnë funksionimin e përditshëm më të lehtë, për ekipin tuaj, klientët dhe proceset tuaja operationale.

8.1 Lehtësira për Stafin dhe Drejtuesit Ekzekutiv

Një ekip produktiv ka nevojë për një ambient funksional dhe të aksesueshëm. Vertigo përfshin struktura mbështetëse të dedikuara që përmirësojnë përvojën në punë:

- Kafene dhe restorante me shërbim të shpejtë
- Hapësira relaksi dhe ambiente të gjelbra në natyrë
- Zona takimesh dhe hapësira informale biznesi
- Bankomat, sportel banke dhe dyqane të domosdoshme
- Parkim për stafin dhe vizitorët
- Siguri dhe kontroll hyrje-dalje 24/7



8.2 Akomodim për Stafin

Vertigo Free Zone ofron gjithashtu njësi akomodimi të dedikuara për punonjësit, ideale për:

- Reduktimin e kohës së udhëtimit dhe kostove të transportit
- Akomodimin e përkohshëm të stafit të huaj apo kontraktorët
- Fleksibilitet gjatë punës me turne

8.3 Shërbime që Mbështesin Funkzionimin e Biznesit Tuaj

- Mbështetje për menaxhimin e objekteve (mirëmbajtje, pastrim)
- Ekipet teknike në gatishmëri për asistencë infrastrukturore
- Menaxhim mbeturinash në përputhje me standardet mjedisore
- Koordinim i përditshëm logjistik (nëse kërkohet)

Më Shumë se një Vendndodhje

Me detajet operationale të menaxhuara dhe shërbimet pranë jush, biznesi juaj mund të fokusohet te prodhimi, tregtia dhe zhvillimi, dhe jo te logjistika, vonesat apo pengesat e përditshme.







+355 69 608 5881
contact@vertigo.al
Xhafzotaj, Durrës, Albania
www.vertigofreezone.com